



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**  
**DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL**  
**Sektori i Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve**

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 10 datë 19 . 08 .2023

**"Për pranimin e të moshuarit z.Myftar Zagani në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në vkm 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar " Kreu III Pika 13. A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a); pika 24; Kreu IV " Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes " Pika 58, c) pika 59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit:

**PROPOZOJMË**

1-Pranimin në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush të z.Myftar Zagani me nr ID E31226013P duke i ofruar:

- Strehim
- Ushqim
- Përkujdesje Shëndetësore
- Përkujdesje Social -Psikologjike

2- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike,sipas percaktimit te nenit 55,pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"i ndryshuar.

**I paraqitet Këshillit Bashkiak për të marrë vendimin**

**KRYETAR**  
**KRISTIAN SHKRELI**

**NE MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETARI**  
**Gjovalin Zefi**



**Konceptoi:** Spec. Florinda Ndokaj  
**Pranoi:** P/Sektori. Çuka Babani  
**Miratoi:** D/Drejtoria. Ridvan Luzaku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJES  
DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
Sektori i Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vau Dejës me \_\_\_\_\_, 2023

RELACION

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në Ligjin 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", në VKM 518 Datë 04.09.2018 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për përfitim të tyre dhe Masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", Kreu III-Procedurat, Pika 13-a); Pika 14; Pika 17; Pika 18; Pika 23-a); Pika 24. Kreu IV "Kriteret e Përfitimit të Shërbimit dhe Përmbajtja e Dosjes" Pika 58-Ç), Pika 59.

Z. Myftar Zagani ka paraqitur kërkesën pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit për të Moshuar "Besa", Barbullush. Z. Myftar Zagani është shprehur se ka humbur bashkëshorten dhe se jeton i vetëm. Ai e ka të pamundur të kujdeset për veten e tij si nga ana ekonomike ashtu dhe nga gjëndja e tij shëndetësore. Z. Myftar Zagani jeton i vetëm dhe i braktisur nga fëmijët dhe të afërmit. I gjendur në kushte të tilla dhe i braktisur nga fëmijët dhe të afërmit kërkon që të sistemohet në një qendër të moshuarish pasi socializimi me të tjerët dhe shërbimi në qendër do bënte që të kalonte ditë më të qeta dhe më të lumtura. I moshuari është me pasaportizim në Shkjetë-Njësi Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës. Duke parë gjëndjen e tij shëndetësore, ekonomike dhe sociale do ishte i përshtatshëm sistemimi i tij në qendrën për të moshuar "Besa", Barbullush.

Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr.13 datë 09.03.2023 "Për ngritjen e Komisionit Multidisiplinar për vlerësimin e rasteve të personave që kanë nevojë për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar dhe rezidencial publik dhe jopublik" bëri vlerësimin e dokumentacionit. Nisur sa më sipër i moshuari Z. Myftar Zagani plotëson kriteret sipas dokumentave dhe të dhënave:

- a) Çertifikatë personale nga Rregjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010
- b) Çertifikatë Familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010
- c) Fotografë të individit 2 (copë)
- ç) Raportin mjekësor që përcakton gjëndjen shëndetësore

d) Vërtetim nga sigurimet shoqërore me masen dhe llojin e pensionit që përfiton , nga sistemi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore

e) Vërtetimi i gjendjes social-ekonomike të familjes të kryer nga administratori shoqëror sipas formularit të miratuar me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale

f) Vërtetimi nga ZRPP-ja Aluizni për pronat që ka në zotërim

g) Vërtetimin nga sistemi bankar të burimeve financiare të individit; i marrë me autorizimin përkatës të individit. (Ky verifikim do realizohet në vazhdim. Momentalisht mbështetemi në deklaratën e nënshkruar nga vetë e moshuari )

h) Kërkesë për azil.

i) Deklaratë Astrit Zagani

j) Deklaratë Shkëlqim Zagani


Gjithashtu duke ju referuar edhe shqyrtimin e gjendjes sociale të të moshuarit Myftar Zagani të paraqitur nga administratori shoqëror sipas modelit formular përkatës, rezulton se i moshuari banon në shtëpinë e djalit të tij, është i vetmuar dhe pa kujdesje nga asnjë njeri.


Nisur nga të dhënat e mësipërme i propozojmë Këshillit të Bashkisë pranimin e të moshuarit në Qendrën e përkujdesit social për të moshuar "Besa" Barbullush.

*Ju falenderojmë për bashkëpunimin!*

**Komisioni multifunksional i pranimeve**

Stefan Jaku  


Edmond Gjerd  


Errolta Gera  







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Vau-dejës

Njësia administrative Bushat

Zyra e Gjendjes Civile 338



Data: 14.07.2023

### CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Data lindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Myftar ZAGANI	Shah	Sadije	M	Kryefamiljar	26-12-1943	I/e ve	Shkëzë, Shkodër	Shqiptare	E31226013P
2.	-----									
3.	-----									
4.	-----									
5.	-----									
6.	-----									
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për \_\_\_\_\_

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e  
Përgjithshme e Gjendjes Civile  
Data: 2023/07/14 09:30:35 +0200  
931384202307140930279801001



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)